

Përgjigjet e “Testoni njohuritë tuaja”
Testoni njohuritë tuaja 1 – Dive (diferencat e përkohshme)

	Vlera kontabël \$	Baza tatimore \$	Diferenca e përkohshme \$
Aktivi afatgjatë	82,000	70,000	12,000
Interesi i arkëtueshëm	1,000	Nul	1,000
Llogari të arkëtueshme	10,000	10,000	Nul
Inventari	4,500	5,000	(500)
Të drejtat dhe detyrimet e konstatuara (baza e mjeteve monetare për tatimin)	(1,000)	Nul	(1,000)
Të drejtat dhe detyrimet e konstatuara (tashmë ka lehtësim tatimor)	(5,000)	(5,000)	Nul

Testoni njohuritë tuaja 2 – Dive (llogaritja e tatimit të shtyrë)

Diferenca e përkohshme neto në datën e raportimit është si më poshtë:

	\$
Aktivitet afatgjatë	12,000
Interesi i arkëtueshëm	1,000
Llogari të arkëtueshme	-
Inventari	(500)
Të drejtat dhe detyrimet e konstatuara (baza e mjeteve monetare për tatimin)	(1,000)
Të drejtat dhe detyrimet e konstatuara (tashmë kishte lehtësim tatimor)	-
	11,500

Do të ketë një detyrim tatimor të shtyrë sepse vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve neto tejkalon bazën tatimore neto. Detyrimi tatimor i shtyrë llogaritet duke aplikuar normën tatimore përkatëse në diferencën e përkohshme.

Detyrimi tatimor i shtyrë është 3,450 \$ ($11,500 \$ \times 30\%$).

Duke supozuar se nuk ka asnjë pasiv për tatimin e shtyrë, kërkohet të bëhet regjistrimi kontabël i mëposhtëm:

Debi: Shpenzimi tatimor (PASH)	3,450 \$
Kredi: Detyrimi tatimor i shtyrë (Pasqyra e pozicionit financiar)	3,450 \$

Testoni njohuritë tuaja 3 - Brick

Detyrimet tatimore të shtyra dhe aktivet duhet të maten, duke përdorur normat tatimore që pritet të zbatohen kur aktivi realizohet. Kjo normë tatimore duhet të jetë miratuar ose do të miratohet në fund të periudhës së raportimit.

Qeveria miratoi normën tatimore 20% pas përfundimit të periudhës së raportimit. Prandaj, ajo nuk duhet të përdoret kur llogaritet detyrimi tatimor i shtyrë për vitin që përfundon më 30 prill 20X4. Në vend të kësaj, duhet të përdoret niveli aktual 22%.

Sipas SNK 10, ndryshimet në normën tatimore pas përfundimit të periudhës raportuese janë ngjarje jo-rregulluese. Sidoqoftë, nëse ndryshimi në normën tatimore konsiderohet material, Brick duhet të japë shënime shpjeguese për këtë ndryshim të normës dhe një vlerësim të ndikimit financiar.

Testoni njohuritë tuaja 4 - Dodge

Vlera kontabël e aktivitet është 90,000 \$ dhe baza tatimore është 50,000 \$ ($100,000 \$ - 50,000 \$$). Vlera kontabël e tejkalon bazën tatimore me 40,000 \$ ($90,000 \$ - 50,000 \$$).

Kjo diferencë e përkohshme do të krijojë një detyrim tatimor të shtyrë prej 12,000 \$ ($40,000 \$ \times 30\%$).

Përpara rivlerësimit, vlera kontabël e aktivitet ishte 60,000 \$. Aktivi u rivlerësua në 90,000 \$. Prandaj, 30,000 dollarë ($90,000 \$ - 60,000 \$$) të diferencës së përkohshme lidhen me rivlerësimin. Fitimet e rivlerësimit regjistrohen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, kështu që ngarkimi i tatimit të shtyrë që lidhet me fitimin, duhet gjithashtu të regjistrohet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Kjo nënkutpon që tatimi i ngarkuar në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse është 9,000 \$ ($30,000 \times 30\%$).

Kërkohet të bëhet regjistrimi i mëposhtëm:

Debi: Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse	9,000 \$
Debi: Fitimi ose humbja (shifrat në bilac)	3,000 \$

Kredi: Detyimi tatimor i shtyrë

12,000 \$

Teprica e rezervës së rivlerësimit brenda përbërësve të tjerë të kapitalit do të jetë 21,000 \$ (fitimi nga rivlerësimi 30,000 \$ - tatimi i shtyrë 9,000 \$).

Testoni njohuritë tuaja 5 – Splash

Shpenzimi i njohur për një transaksion pagese aksionesh i shlyer në kapital llogaritet në bazë të vlerës së drejtë të opsioneve në datën e kushtëzimit. Ky shpenzim shpërndahet gjatë periudhës së kushtëzimit. Në secilën datë raportimi, entiteti duhet të rivlerësojë numrin e opsioneve që priten të kushtëzohen.

Shpenzimi për skemën e vitit që përfundoi më 30 qershor 20X9 është 250,000 \$ ($4 \times 25,000 \times 10 \$ \times 1/4$).

Për qëllime tatimore, lehtësimi tatimor lejohet bazuar në vlerën e brendshme të opsioneve në datën kur ato janë ushtruar.

Në datën e raportimit, aksionet kanë një vlerë tregu prej 17 \$, por opsionet u lejojnë mbajtësve të tyre t'i blejnë këto aksione për 5 \$. Opsionet pra kanë një vlerë të brendshme prej 12 \$ ($17\$ - 5 \$$).

Aktivi tatimor i shtyrë llogaritet si më poshtë:

	\$	\$
Vlera kontabël e pagesave të bazuara në aksione	Nul	
Baza tatimore e pagesave të bazuara në aksione		
$(4 \times 25,000 \times (17\$ - 5\$) \times \frac{1}{4})$	(300,000)	
x norma tatimore 30%	(300,000)	
Aktivi tatimor i shtyrë		90,000

Kur shuma e zbritjes tatimore të parashikuar në të ardhmen tejkalon shpenzimin e akumuluar të shpërblimit, kjo tregon që zbritja tatimore lidhet pjesërisht me shpenzimet e shpërblimit dhe pjesërisht me kapitalin.

Në këtë rast, zbritja tatimore e parashikuar në të ardhmen është 300,000 \$, ndërsa shpenzimi i akumuluar i shpërblimit është 250,000 \$. Prandaj, 50,000 \$ e diferencës së përkohshme vlerësohet se lidhet me një zë të kapitalit dhe tatimi i shtyrë në lidhje me këtë duhet të kreditohet në kapital.

Kërkohet të bëhet regjistrimi i mëposhtëm:

Debi: Aktivi tatimor i shtyrë	90,000 \$
Kredi: Kapitali (50,000 \$ x 30%)	15,000 \$
Kredi: Fitimi ose humbja (250,000 x 30%)	75,000 \$

Nëse aktivi tatimor i shtyrë është për tu njohur, ai duhet të konsiderohet si i rikuperueshëm.

Testoni njohuritë tuaja 6 – Red

Një aktiv tatimor i shtyrë mund të njihet nëse shikohet e mundur që fitimet e tatueshme në të ardhmen do të jenë në dispozicion kundrejt të cilave humbjet e papërdorura mund të jenë të dobishme.

Humbjet tatimore kanë lindur nga një ngjarje e jashtëzakonshme, duke shpresuar që entiteti do ta kthejë në përfitueshmëri. Parashikimet e nxjerra nga kontabilisti e konfirmojnë këtë.

Red është në gjendje që të parashikojë në mënyrë të besueshme vetëm përfitimet e ardhshme prej 2.5 mln \$. Kjo kufizon aktivin tatimor të shtyrë që mund të njihet.

Tatimi i shtyrë duhet të llogaritet duke përdorur normën tatimore që pritet të jetë në fuqi kur diferenca e përkohshme ndryshon bazuar në normat e miratuara në datën e raportimit. Kjo do të thotë që duhet të përdoret norma 28%.

Aktivi tatimor i shtyrë që mund të njihet është 700,000 \$ (2.5 mln \$ × 28%). Do të ketë një kreditim korrespondues të shpenzimeve tatimore në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Testoni njohuritë tuaja 7 – Tom

Sipas SNRF 3, aktivet neto të filialit në datën e blerjes duhet të konsolidohen me vlerën e drejtë. Vlera kontabël e inventarit në pasqyrat financiare të grupit do të jetë 55,000 \$. Baza tatimore e inventarit bazohet në vlerën kontabël prej 50,000 \$ në pasqyrat financiare individuale. Prandaj, ekziston një diferencë e përkohshme prej 5,000 \$ që lind në konsolidim.

Një detyrim tatimor i shtyrë duhet të njihet në pasqyrat financiare të konsoliduara për 1,500 \$ (5,000 \$ × 30%). Kjo trajtohet si një ulje e aktiveve neto të filialit në datën e blerjes, e cila do të rrisë emrin e mirë që lind nga blerja.

	\$	\$
Konsiderata		300,000
Aktivet neto:		
Vlera kontabël	250,000	

Rritja e vlerës së drejtë	5,000	
Detyrim tatimor i shtyrë	<u>(1,500)</u>	(253,500)
Emri i mirë në blerje		46,500

Testoni njohuritë tuaja 8 - Mug

Një shitje është kryer brenda grupit, gjithashtu edhe disa nga inventarët mbetën brenda grupit në datën e raportimit. Fitimet e mbajtura brenda këtij inventari të pashtur duhet të hiqen nga pasqyrat e konsoliduara.

Fitimi nga shitja ishte 100,000 \$ (250,000 \$ × 40%). Nga kjo, 25,000 \$ (100,000 \$ × 25%) mbetet brenda inventarit të grupit.

Rregullimi i kërkuar për të eliminuar fitimet e porealizuara është:

Debi: Kostoja e shitjes 25,000 \$

Kredi: Inventari 25,000 \$

Vlera kontabël e inventarit në pasqyrat financiare të konsoliduara tani është 25,000 \$ më e ulët se baza e saj tatimore, duke krijuar një diferencë të përkohshme të zbritshme prej 25,000 \$. Kjo krijon një aktiv tatimor të shtyrë prej 5,000 \$ (25,000 \$ × 20%) në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar, si dhe një ulje korresponduese të shpenzimit tatimor në pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes.

Rregullimi i kërkuar për të llogaritur tatimin e shtyrë është:

Debi: Aktivi tatimor i shtyrë 5,000 \$

Kredi: Shpenzimi tatimor 5,000 \$

Testoni njohuritë tuaja 9 - HCRM

Përdoruesit e pasqyrave financiare kanë nevojë për informacion, i cili do t'i ndihmojë ata të vlerësojnë fitimet e ardhshme të entitetit dhe flukset e ardhshme të mjeteve monetare. Rikoncilimi i normës tatimore është i rëndësishëm për të kuptuar ngarkimin tatimor të raportuar në pasqyrat financiare dhe pse norma efektive e tatimeve ndryshon nga norma ligjore.

Arsyeja kryesore e ndryshimit midis normës tatimore ligjore dhe normës tatimore efektive është për shkak të rregullimeve tatimore aktuale. HCRM është nënvlerësuar në periudhat e mëparshme për tatimin aktual, duke sjellë kështu shpenzime shtesë në periudhën aktuale. Investitorët duhet të vlerësojnë nëse norma efektive e tatimit ka të ngjarë të jetë statike ose e paqëndrueshme dhe kështu

duhet të analizojë informacionin krahasues për të kuptuar nëse HCRM ka një histori të nënvlerësimit (ose mbivlerësimit) për tatimin aktual. Kjo do të informojë parashikimet e fitimit dhe flukseve të mjeteve monetare.

Zërat e përkohshëm dhe të pazakontë mund të kenë një efekt të rëndësishëm në normën efektive tatimore. Zhvlerësimi i aktiveve që nuk kualifikohen për lehtësim tatimor, ka të ngjarë të jenë zëra periodik nga viti në vit. Zërat e tjerë rakordues duhet të shpjegohen në mënyrë që investitorët të mund të vlerësojnë nëse ata kanë të ngjarë të përsëriten. Për të siguruar transparencë, duhet të ketë përdorim minimal të kategorisë "sundry disallowables". Në rakodrimin e HCRM, kjo kategori **sundry** është relativisht e parëndësishme, megjithëse më shumë informacion mund të jenë i dobishëm në varësi të natyrës së këtyre zërave.

Investitorët gjithashtu duhet t'i referohen pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare, e cila do të tregojë tatimin e paguar në periudhën aktuale.